



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

REKTORI
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT

Tiranë, më 10.11. 2025

Lënda : Njoftim për shpallje konkursi për 4 (katër) vende pune për personel administrativ, me kohë të plotë në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

DREJTORISË SË ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE DIXHITALIZIMIT TË SHËRBIMEVE AKADEMIKO-SHKENCORE

KËTU

Universiteti i Sporteve të Tiranës, bazuar në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, gërma f, neni 67, pika 3, në Statutin e UST-së, kreu V, Neni 66, pika 1, gërma d); në Rregulloren e UST-së, neni 41 “*Personeli Administrativ*”, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 27, datë 21.05.2021 “*Për miratimin e rregullores së rekrutimit të personelit administrativ në Universitetin e Sporteve të Tiranës*”, në VKM nr. 305, datë 05.04.2017 “*Për disa shtesa në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të ndryshuar, në Vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 60, datë 20.12.2021 “Për miratimin e kriterëve për pozicionet e punës për 3 (tre) pozicione pune si “Përgjegjës Sektori dhe Specialist/e pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në UST”, në Vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 41, datë 17.07.2025 “Për një ndryshim në Vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 67, datë 29.09.2023 “Për miratimin e kriterëve për pozicionet e punës në administratë”, në Vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 78, datë 20.11.2023 “Për miratimin e kriterëve për pozicionet e punës në administratë”, në Vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 31, datë 18.04.2023 “Për miratimin e kriterëve për pozicionet e punës në administratë”, në Vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 51, datë 14.11.2022 “Për miratimin e kriterëve për pozicionet e punës në administratë”, shpall kriteret për 4 (katër) vende pune për personel administrativ, me kohë të plotë në Universitetin e Sporteve të Tiranës.*

- 1 (një) “**Drejtor**”, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit.
- 1 (një) “**Drejtor**”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.
- 2 (dy) “**Specialist/e**”, në Sektorin e Prokurimeve pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

I. Kriteret për hapjen e procedurave të konkursit për 1 (një) pozicion pune “**Drejtor**” në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit janë si më poshtë:

Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:

1. Diplomimi në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës;
2. Kandidati duhet të zotërojë diplomë të ciklit të parë (Bachelor) dhe ciklin e dytë (Master), ose Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND) mbështetur në VKM "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura". (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi);
3. Të jetë i aftë për punë.
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë;
5. Ndaj tij/saj të mos ketë masa disiplinore në fuqi.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:

1. Të ketë diplomë të nivelit "Bachelor" dhe "Master Shkencor" ose DIND në shkenca ekonomike, profili financë ose kontabilitet. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
2. Të ketë përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e menaxhimit, financës ose kontabilitetit.
3. Të njohë legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiarë.
4. Të njohë dhe të përdorë programet bazë të punës në kompjuter, sidomos programin e kontabilitetit dhe të ketë certifikimet përkatëse.
5. Të ketë aftësi të mira komunikimi, etike profesionale dhe të dijë të punojë në grup.

II. Kriteret për hapjen e procedurave të konkursit për 1 (një) pozicion pune si "Drejtor" në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse janë si më poshtë:

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:

1. Arsimimi: Kandidati që konkuron në pozicionin e punës duhet të zotërojë së paku diplomë Master Profesional në fushën e drejtësisë ose ekonomikut.
2. Përvoja: Të ketë përvojë pune të paktën 5 (pesë) vjet në profesion.
3. Tjetër: Njohuri të legjislacionit dhe procedurave të tjera administrative e juridike, njohuri në prokurimet publike.

III. Kriteret për hapjen e procedurave të konkursit për 2 (dy) pozicione pune si "Specialist/e" në Sektorin e Prokurimeve pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse , janë si më poshtë:

Kriteret e përgjithshme:

1. Diplomimi në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës në shkenca ekonomike/ juridike/inxhinierike.
2. Kandidati duhet të zotërojë diplomë të ciklit të parë ose të dytë, mbështetur në VKM

“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura “. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi);

3. Të ketë përvojë të mëparshme pune;
4. Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
5. Ndaj tij të mos ketë masa disiplinore në fuqi.
6. Të jetë i aftë për punë.

Kriteret e veçanta

1. Të ketë diplomë të nivelit “Bachelor” dhe “Master Profesional” ose DIND në shkencë ekonomike.
2. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 1 vit.
3. Të njohë dhe të përdorë programet bazë të punës në kompjuter.
4. Të ketë aftësi të mira komunikimi, etike profesionale dhe të dijë të punojë në grup.

Vlerësimi i intervistës për kandidatët që konkurojnë për këto vende pune është:

1. Vlerësimi i Kandidatit në Total është me 100 pikë, 30 pikë nga intervista dhe 70 pikë nga kriteret e përcaktuara.
2. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:
 - a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

V. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
2. Një kopje jetëshkrimi;
3. Diplomë e shkollës së lartë dhe certifikatë notash e noterizuar.
 - Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
 - Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
4. Diploma e certifikata të ndryshme të kualifikimeve të noterizuara.
5. Dëshmi penaliteti/formulare vetedeklarimi
6. Fotokopje e librezës së punës ose vërtetim nga institucionet ku ka punuar.
7. Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm.
8. Certifikatë e gjendjes familjare .
9. Raport mjeko-ligjor që vërteton aftësinë për punë.

VI. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve të shpallura:

- Dokumentacioni i dorëzuar me anë të shërbimit postar dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të ketyre kandidatëve.

VII . Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit në faqen Agjensisë së Prokurimit Publik.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Drejtoria, emri, mbiemri, adresa e konkurentit.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.
- Kandidatët do të njoftohen me e-mail nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit për datën e zhvillimit të intervistës.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT